




Shënime mbi monografinë
NDIKIMI I ANGLISHTES NË SHTYPIN SHQIPTAR PASKOMUNIST
të autores Irena Pata Kapo

Dr. Irena Pata Kapo paraqitet me një studim me vlerë për gjuhësinë, për gjuhën shqipe me analizën e kryer mbi ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe, sjelljen e anglicizmave dhe përshtatjen e tyre duke iu nënshtruar disa rregullave të gjuhës pritëse.

Ky punim është një kontribut për gjuhën shqipe, pasi siç theksohet edhe në punim ka mungesa të studimeve në këtë fushë për shqipen. Rëndësia e përzgjedhjes së kësaj teme theksohet edhe nga fakti se gjuha shqipe si gjuhë e gjallë dhe në kontakt me anglishten për arsyt e parashtuara në punim, pasurohet më tej me anglicizma duke iu nënshtruar ligjeve të brendshme të saj, duke u modernizuar për t'i mundësuar përdoruesve të saj një komunikim më efektiv, duke shprehur drejt konceptet dhe objektet e reja që çdo ditë futen në jetë dhe në gjuhë.

Punimi ka vlerë, së pari, për faktin se janë analizuar kushtet ekonomike, shoqërore dhe politike që ndikojnë në praninë e anglicizmave në gjuhën shqipe. Si i tillë ai është me vlerë për studiuesit e gjuhës, për gazetarët dhe për hartuesit e fjalorëve dhe për mësuesit e gjuhëve të huaja.

Së dyti, është marrë në analizë një korpus shumë i gjerë gjuhësor i vjelë nga botimet e përditshme dhe periodike të cilat kanë lulëzuar në këtë periudhë, me një shtrirje të gjatë kohore, me ndryshime të rëndësishme në psikologjinë e njerëzve, në këndvështrimet e tyre mbi gjuhën, shoqërinë dhe marrëdhëniet gjuhësore ku shtypi ka pasur ndikim shumë të madh. Si rezultat i studimit në gjuhën e sotme shqipe përdoren 511 anglicizma aktive.

Dr Irena Pata Kapo ka përcaktuar qartë objektin e punimit, që përbëhet nga huazimet leksikore të drejtpërdrejta angleze në shtypin shqiptar të periudhës paskomuniste, në territorin e Shqipërisë.

Hipoteza e studimit që vërtetohet nga kërkimet, analizat dhe glosari i paraqitur është se vihet re rritja e numrit të anglicizmave në gjuhën e medias së shkruar pas viteve '90 dhe se një pjesë ë mirë e tyre është ngulitur në shqipe duke u integruar në sistemin e saj gramatikor, morfologjik, semantik dhe fonetik.

Synimi kryesor është të përcaktojë me përafërsi sa më të madhe korpusin e anglicizmave në gjuhën shqipe dhe vendin e këtyre huazimeve në sistemin leksikor të shqipes, të paraqesë procesin të cilit i nënshtrohen këto huazime si dhe të përcaktojë rëndësinë e tyre në gjuhën shqipe.

Autorja e disertacionit ka ndjekur një model përshkrues, sinkronik duke përdorur metodat e vëzhgimit, analizën e organeve të shtypit shqiptar të periudhës paskomuniste, analizën e huazimeve dhe proceseve e ndryshimeve që ato kanë kaluar në gjuhën pritëse. Nëntë krerët e punimit paraqesin koherencë logjike të trajtimit të temës së punimit. Dy krerët e parë shpjegojnë arsyet objektive jashtëgjuhësore të ndikimit të anglishtes në shqipe si dhe identifikimin e anglicizmave në shqipe. Përcaktimi i qartë i objektit të anglicizmave ka përcaktuar qartë objektin e studimit të ndërmarrë.

Kreu i tretë, me 108 faqe, *Glosari i anglicizmave të shtypit*, paraqet një punë serioze, në bazë të kriterëve shkencorë për ndërtimin e një glosari, bazuar nga qëmtimet në shtypin e kohës. Çdo fjalë jepet si në trajtën përfaqësuese, por edhe në format e ndryshme të hasura gjatë kërkimit. Kjo vërteton se këto fjalë janë përshtatur mirë me gjuhën shqipe duke iu nënshtruar rregullave të saj.

Në kapitujt katër, pesë, gjashtë, shtatë dhe tetë bëhet analiza e anglicizmave nga ana fonetike, përshtatja e shkrimit, përshtatja morfologjike, përdorimi i anglicizmave sipas fushave sintaksore, nga ana semantike. Analiza dhe përfundimet për këto procese janë bërë bazuar mbi materialin e bollshëm leksikor të vjelë gjatë kërkimeve. Punimi vë në dukje se 87.65 e huazimeve janë të kategorisë leksiko-gramatikore të emrit, e ndjekur me mbiemra 12.7 %, folje 4.1%, dhe ndajfolje 0.9%, që vërteton se shumica e huazimeve janë emra që lidhen me idetë dhe objektet e reja të futura në jetën shqiptare.

Kreu IX paraqet një liste propozuese me anglicizma për t'u përfshirë në Fjalorin e Gjuhës Shqipe. Ky propozim bazohet në një analizë që ka të bëjë me shpeshësinë dhe dendurinë e përdorimit, me mënyrën e pranimit të tyre nga gjuha shqipe dhe me plotësimin e nevojave shënjuese të gjuhës shqipe.

Përfundimet e dhëna bazohen në ligjësitë gjuhësore dhe të zhvillimit shoqëror. Autorja ndan mendimin e autorëve të tjerë se huazimet janë të nevojshme si plotësuese të nevojave të gjuhës sonë, si kontribuese në modernizimin e saj. Këto përfundime vërtetojnë hipotezën dhe synimet e tij.

Punimi duke sqaruar anglicizmat si pjesë e rëndësishme e leksikut gazetaresk thekson rëndësinë e tyre për vlerën e lartë shënjuese, si nevojë leksikore, si mjete me një ngjyrim më të madh emocional. Në përgjithësi ato më të përdorshmet janë njësuar në gjuhën shqipe.

Në punim tregohen gjithashtu edhe rastet kur një anglicizëm përdoret për një kohë të shkurtër, rastet kur ka lidhje me një ngjarje të caktuar, kur futet në përdorim nga persona me njohuri të pakta të gjuhës angleze, kur përdoret në reklama dhe në tendencën për të përdorur sa më shumë sinonime.

Gjuha jonë është në zhvillim dhe në pasurim. Është detyra e studiuesve, gazetarëve dhe mësuesve të gjuhës së huaj të punojnë për mbrojtjen dhe pasurimin e saj. Gjuha e përdorur në punim është një gjuhë e pasur, e pastër dhe shkencore. Punimi ka respektuar rregullat e një punimi shkencor duke u bazuar në referime dhe burime të përcaktuara drejt.

Bibliografia është e pasur me autorë shqiptarë dhe të huaj që kanë punuar për huazimet. Burimet e marrjes së korpusit të fjalëve përfshijnë periodikët dhe gazetatat ditore më të lexuara në Shqipëri. Monografia e përgatitur nga Dr. Irena Pata Kapo është një punim i punuar me kujdes, sipas kërkesave të një punimi shkencor, i cili është një ndihmesë në gjuhësinë shqiptare.

Prof. Dr. Elida Tabaku